

## Mallkimi i epirotit (1483)

Në këtë punim i jemi përkushtuar analizës filologjike të një teksti njëfjali, i mirënjohnur në analet e historisë së kulturës së shkrimit shqip me emrin *Formula e Mallkimit*, e cila falë motit të dokumentimit, bash në vitin 1483, mëton sot e gjithë ditën vendin e dytë në trashëgiminë historike të lëvrimit të kësaj gjuhe.<sup>1</sup> Dalja në dritë atëbotë lejon gjithsesi të vendosim një bashkëlidhje kronologjike të pandërmjetme me atë qerthull tematik të rrahur aq fort vitet e fundit, në të cilin vatrëzohen në një epoka që jetoi dhe përjetoi personi historik Gjergj Kastrioti (= Georg Castriota 1405 – 1468) me mitin e heroit legjendar Skënderbe (= Scanderbeg), përkatesisht jehona dhe legjenda që lanë pas së bashku të dy këta emra në historinë e shqiptarëve e të Shqipërisë mesjetare. Një bashkëlidhje të ndërmjetme midis studimit të kësaj formule me personin historik dhe heroit legjendar arrijmë ta përsiasim dhe tumirim gjithashtu po pa vështirësi, por për ta shtjelluar këtë sado thukët, do të duhej të hapnim që në fillim një parantezë, duke iu shmangur kështu vetë objektit të mirëfilltë të studimit tonë, andaj e shohim shumë më të arsyeshme t'i përcjellim këto përsiatje në formë epilogu në fund të tij.

### 1. Përshkrim i shkurtër i parateksteve

#### a) Formula e Mallkimit dhe rrethanat e zbulimit të saj

Hyjmë kështu menjëherë në temë, duke theksuar paraprakisht se zbulimin e *Formulës* (së *Mallkimit*) lejohemi ta përcjellim fare mirë si sendërtim i bashkëpunimit të suksesshëm ndërdisiplinor midis një latinisti filolog dhe një albanologu, siç janë dy zbuluesit e saj. I pari, Ludwig Braun, është ai që u përball po i pari me këtë tekst njëfjali – për të gjithsesi krejt i panjohur, që vjen me thënë gjuhësish i pazbërthyeshëm – bash gjatë punës së tij për ripërkthimin gjermanisht të komedisë “Epirota”, shkruar dhe botuar latinisht në vitin 1483 në Venedik<sup>2</sup> e që ka për autor Tommaso de Mezzo-n [= ven. Tomà de Mezzo].<sup>3</sup> I dyti,

1 Teksti më i hershëm shqip që njohim deri sot është *Formula e Pagëzimit* që datohet në vitin 1462 e që ka për autor ipeshkvin e atëhershëm të Dioqezës së Durrësit, Imzot Pal Engjëllin: <Vnte' paghesont premenit Atit et birit et spertit senit> = |Un' te pagezonj pr' emenit' atit e t' birit e t' shpertit shenjt|. Shih së fundi në detaj Matzinger 2010 44vv.

2 Për hollësi të mëtejshme të karakterit biografik lidhur me autorin dhe botimet e veprës së tij shih Braun – Camaj 1972 2v.; Braun 1974 9vv.; Matzinger 2010 44v.

3 Tomà parapëlqente atëbotë ta shkruante emrin e vet në formë të latinizuar: Thomas Medius,

Martin Camaj, është pikërisht ai që zbërtheu i pari enigmën gjuhësore të tekstit, duke e cilësuar atë si një formulë mallkimi në gjuhën shqipe. Fryt i këtij bashkëpunimi intensiv është edhe botimi i përbashkët i një punimi mbi këtë zbulim fatlum në historinë e kulturës së shkrimit shqip në "Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung" (86 [1972] 1-6).<sup>4</sup>

Sigurisht që do të ishim të paplotë sikur të mos vinim në pah edhe një detaj të dytë në këtë bashkëpunim farëmirë: Zbërthimi i enigmës gjuhësore të Formulës prej Camajt i mundësoi kolegut të tij jo vetëm të plotësojë ndonjë boshllék në strukturën e tekstit letrar si një komedi e shkruar në fryshtë tipike humaniste të kohës, por edhe të syzojë njëherësh modelin burimor ku ishte mbështetur autorit i saj, përkatësisht të zbërthejë enigmën që bartë vetë titulli i komedisë. Bëhet fjalë këtu për një imitim në detaj, madje deri në pagëzimin me atë titull, të veprës së komedianit të Romës antike, Plautit (Titus Maccius Plautus: rrëth 254 – 184 p. e. s.), pikërisht të komedisë së tij "Poenulus" [= Puni vogëllith/ Kartagjenasi i vogël – B.D.], të cilit Plauti nuk mungon t'i vëré në gojë edhe ndonjë frazë në gjuhën amtare (Poenulus rr. 930-949, 995 etj.) Të njëjtën hulli ndjek në komedinë e vet edhe Tommaso de Mezzo, të cilën e titullon "Epirota" [= Epirota – B.D.] e ku gjithashtu nuk mungon me vënë në gjuhën e personazhit të vet, epirotit, pikërisht atë tekst-njëfjali: <Drâburi te clofto goglie> (Epirota: skena 11 rr. 803). Në periudhën e humanizmit dhe të renesancës evropiane, madje deri vonë në kapërcyell të mesjetës e më pas, shënjuesit etnikë diturakë: *epirot ~ Epir ~ gjuhë epirote* [= lat. epirota, Epirus, lingua epirotica] parapëlqeheshin në përdorim në rrethet intelektuale, letrare e klerikale të kohës, ku ata shfaqeshin vetëm si sinonime të shënjuesve etnikë *arbën/r ~ Arbën, Dheu i Arbënit, Arbëni/ri ~ abënuer/arbëror, i arbënesh/arbëresh*. përkatësisht më vonë *shqiptar ~ Shqipni/Shqipëri ~ (gjuhë) shqipe*. Këtë asociacion etnik gjuhësor-historik e ndjekin me besnikëri dhe në vazhdimësi edhe intelektualët dhe klerikët katolikë shqiptarë, përkatësisht syresh me origjinë shqiptare gjatë gjithë periudhës së mesjetës.<sup>5</sup> Këtë rrethanë

duke ndjekur kështu traditën humaniste të kohës. Të dyja variantet e emrit janë sot e gjithë ditën në përdorim kur vjen në fjalë autorësia dhe titulli i kësaj komedie, khs. Ludwig Braun (përkthe. e bot.): Thomae Medii. Fabella Epirota, München 1974, kundrejt Graziella Gentilini: Il teatro umanistico veneto. La commedia (Tommaso Mezzo. Epirota, Giovanni Armonio Marso. Stephanium, Bartolomeo Zamberti. Dolotechne). Ravenna 1983.

4 Njohja dhe zbulimi i Formulës është kryer në fakt në vitin 1970. Në arkivin e familjes Camaj (Lenggries) ndodhet e depozitar edhe një pjesë e korrespondencës së zhvilluar në këtë rast midis të dy studiuesve: Camaj drejtuar Braun-it më: a) 11.7.1970; b) 19.7.70; dhe Braun drejtuar Camajt më c) 14.7.1970.

5 Për përdorimin sinonimik të kohës të çerdheve të shënjuesve etnikë mbi bazën *epir-* dhe *alban-* (= *arbën-*) në rrethet intelektuale gjatë epokës së Gjergj Kastriotit dhe pas tij shih së fundi edhe Schmitt 2009 26. Për përdorimin e tij në periudhat e mëparshme shih Dulaj 1989 22vv.; ndërsa për periudhat e mëvonshme lejohemi të sjellim këtu sa për shembëllzim vetëm Frang

kulturore-historike e tumirim sot e gjithë ditën në albanologji si një realitet historik e gjuhësor i mirëqenë.<sup>6</sup>

## 2. Mallkimi i epirotit dhe rrethanat e përdorimit të tij në tekster

Mallkimin autor i tekstit e vë në gojë të epirotit imagjinar durrasak (lat.) Damascenus, i cili erdhi e zbriti një ditë të bukur me diell në portin sicilian të Sirakuzës, duke ndjekur kështu një informacion që kishte marrë rishtas, se pikërisht në atë qytet-port kishte përfunduar e vetme mbesa e tij Antiphila, vajza e të vëllait, i cili kishte vdekur para do kohësh pa pritur e pa kujtuar në det të hapur, bash gjatë arratisë që kish marrë së bashku me familjen e vet po durrsake për t'u shpëtuar borxheve të mëdha që bartte mbi supe. Pas disa akteve epiroti përfundon në një mejhane për të ngrënë bukë së bashku me një harpist këngëtar (= lat. *citharoedus*) dhe një ekonom (= lat. *dispensator*). Në këtë skenë epiroti ndjek fillimisht me vëmendje dialogun që zhvillohet midis të zotit të mejhaneve (= lat. *caupo*) dhe harpistit, i cili kërkon me çdo kusht të vëré bast me të, me qëllim që ta fitojë e për rrjedhojë të mos paguajnë të gjithë së bashku harxhet, në rast se të zotit të mejhaneve, një përcmues i deklaruar i muzikës, do t'i pëlqente qoftë edhe një këngë e tij e vetme. Epiroti ndërhyr pranë të zotit të mejhaneve dhe i mbush atij mendjen ta pranojë bastin, sepse do ta fitonte atë patjetër. E për këtë mjaftonte që të përgjigjej gjithherë "jo!" pas çdo pyetjeje, nëse i pëlqente njëra apo tjetra këngë e radhës. I bindur se po të vepronë në të tillë mënyrë, ai do ta fitonte patjetër atë bast, epiroti madje hyn dorëzanë me një të tretën e shpenzimeve për gjithë vaftin e ngrënë. Por pas një loje fjalësh në tekstin e një këngë të radhës i zoti i mejhaneve e miratoi pa menduar gjatë pyetjen e bërë nga harpisti duke thënë "po!" për përbajtjen e tekstit, por që ai pohim u njoh si i vlefshëm për vetë këngën, përkatesisht muzikën që shoqëroi tekstin e sajtar nga harpisti. Menjëherë pas kësaj loje fjalësh ndjekim një dialog të shkurtër midis të z(otit të mejhaneve) dhe e(pirotit), si vijon:

### a) *Teksti origjinal:*

Z: Num meministi tu, hospes, non ita pactum esse inter nos? Quid ais? Taces, faex hominum.

E: <Drāburi te clofto goglie!>

Z: Hei mihi, Epirota me prodidit! Ille concitus fallaciae. Terciam in partem damni se scripsit, ut me duabus parti bus multaret.

E: Immo, caupo, si nescis, tota cena multatus es, nam ego ea lege subscripsi, si pernegares, tu autem stulte et pueriliter annisti.

Z: Peril miser, etiam hic tergiversatur. Illi abierunt ....

### b) *Përkthimi shqip:*

Bardhin 1635 22: <Epirus : Arbëni>, <Epirote : i arbenesce, Turcicë Arnautlar> etj.

6 Shih së fundi Demiraj, B. 2002 31.

[Z: shq. : Ty, të kujtohet tash, or mik i huaj, se midis nesh kishte një ujdi.<sup>7</sup> Ç’thua? Ti po hesht; ti, llum i njerëzisë.

E: <Drâburi te clofto goglie!>

Z: Hei!, mua epiroti ma ngriti grackën. Ai e dinte, se unë do të mashtrohesha. Andaj u tregua i gatshëm për një të tretën e harxhit, në mënyrë që të përfitonte nga dy të tretat e tij.

E: Dale dale, hanxhi, meqë s’e ditke (ende): ti je i detyruar përgjithë vaftin, sepse unë hyra dorëzanë vetëm me kusht, që ti gjithnjë ‘të mohosh (= të thuash gjithnjë “jo!”). Ndërsa ti, si kaqol dhe çunak, pohove (= the “po!”). *epiroti largohet*.

Z: I mjeri unë, mora fund! Edhe ky ma ktheu shpinën. Ata ia mbathën ....]

## 2. Interpretimet e derisotme filologjike dhe vështirësitet që lidhen me to

Botimi i Formulës dy vjet më vonë (Braun & Camaj 1972 1vv.) daton njëherësh edhe përpjekjen e parë të interpretimit të saj filologjik. Camaj përsiat këtu së pari bashkëlidhjen me një strukturë paralele formulash mallkimi në shqipen bashkëkohore, të tipit: Predikat (në optativ/dëshirore) + Subjekt, khs.: (tosk.) *mbyllurë të qoftë goja!* ~ (greq.) *të qoftë/ kjoftë mbyllun goja*, përkatësisht: *t'u mbërtheftë goja!*, *t'u mbylltë goja!* Ky konstatim e lejon atë të kumtojë në vazhdim edhe burimin dialektor toskërisht të Formulës, duke i njohur gjymtyrës së saj të parë statusin e një pjesoreje të rotacizuar më ndajshësën {-urë}, zanoren fundore [-ə] të së cilës De Mezzo e paskësh dëgjuar si [-i]. Burimin dialektor toskë e përforcon sipas tij edhe një karakteristikë fonetike-grafike në gjymtyrën e fundit <goglie> “gojë” me grafinë <-gl-> (= [ʎ]), si një tjetër dëshmi më se e qartë që “kjo fjali i takon tipit të hershëm të të folmeve shqipe jugore.” (f. 5)

Vështirësinë kryesore në interpretim Camaj e kushtëzon gjithsesi me qëmtimin e njësisë leksikore follore që sendëronton gjymtyra e parë e Formulës, e cila sipas tij mund të interpretohet në mënyrë dyfishe: a) si pjesore e foljes *mbyll*, khs. pjes. {*mbyllurë*} (= shq. vj./Buzuku <enbulure>); ose b) pjesore e foljes *trëmbem*, \**trámbem* “frikësohem, tmerrohem (nga frika); dridhem”, khs. pjes. {*tramburë*} pranë dial. tosk. {*trëmburë*}. Në rastin e dytë Camaj tumir edhe një proces asimilimi regresiv në distancë, sa i përket zëshmimit që mund të paskësh përjetuar bashkëtingëllorja nistore: \*/t/ → /d/ | #.../b/, khs. \**tramburë* > *dramburë* (= <*drâburi*>). Së fundi Camaj parapëlqen më fort këtë zgjidhje të dytë, duke e zbërthyer paraqitjen grafike të tekstit njëfjali <*drâburi te clofto goglie*> me tejshkrimin sipas tij “më korrekt”

7 Është fjala për dorëzaninë e epirotit, i cili në rast humbjeje të bastit merrte përsipër të pa-guante një të tretën e shumës së vaftit.

në shqipen e sotme |trámburë të kloftë golja (goλa)|, duke i dhënë kështu Formulës kuptimin “t’u dridhtë goja (prej një sëmundjeje ose zemërimi)”.<sup>8</sup>

Një përpjekje të dytë interpretimi të mirëfilltë filologik e përcjellim thuajse katër dekada më vonë, në një punim filologjik shembullor të Matzinger-it mbi kulturën e shkrimit shqip në epokën e Skënderbeut (2010 48vv.), në të cilin autorri merr në analizë ndër të tjera edhe çështje të karakterit grafik, të pacekura më parë, përkatësisht të lëna pa përgjigje nga Camaj, ku feksin: p.sh. a) tejshkrimi i grafisë <clofto> prej Camajt me |kloftë| (= [kloftə]), pra me një ndryshim të dukshëm në timbër të zanores tejfundore; e po ashtu b) tejshkrimi i gjymtyrës përmbyllëse <goglie> prej Camajt me |golja| (= [goλa]), ku ndryshimi në timbër i zanores fundore parakupton edhe sjelljen e saj të ndryshme morfologjike si emër femëror në rasën emërore të shquar.

Ndër këto dy çështje, e dyta mbetet e hapur edhe për Matzinger-in vetë, sipas të cilit: “Mbetet e paqartë, se përsë shfaqet këtu [= në tekstin burimor – B. D.] forma e pashquar e emrit |goljë|, meqë – siç e tumirin edhe mallkimet e ngjashme të sjella për krahasim prej Camajt (& Braun 1972: 4) – këtu do të pritej më fort forma e shquar |golja|. ”<sup>9</sup> Sa i përket çështjes së parë, Matzinger-i përsiat edhe një proces asimilimi progresiv në distancë që duhet të ketë prekur zanoren e patheksuar fundore: \*/ë/ → /o/ | °/ó/...#, khs.: \*[klóf.tə] > [klóf.to]. Përndryshe ai vijon të ecë në hullinë e hapur nga Camaj, duke e vështruar gjymtyrën e parë të Formulës si një pjesore e tipit dialektor toskë, zanorja fundore e së cilës (= [-ə]), krejt e pazakonshme për ndjesinë gjuhësore të autorit joshqipfolës, duhet të jetë perceptuar prej tij si [-i], ndërkohë që edhe grafia <ā> tek varianti burimor <drāburi> mund të interpretohej fare mirë si paraqitje grafike e sekuencës ['əm]. Të gjitha këto përsiatje shtesë Matzinger-i i ngjiz në tejshkrimin e vet tentativ, duke vënë gjithashtu pikëpyetje edhe në kuptimin e propozuar prej Camajt: |dramburi të klofto goljë| “(dein) Mund sei (dir) erzittert(?)” [= (ty) t’u dridhtë goja(?)].<sup>10</sup>

Këto dy interpretime të mirëfillta filologjike dhe gjuhësore të Formulës janë pas gjase edhe tentativat e vetme të bëra deri sot në debatin shkencor albanologjik. Citime të tjera që kemi mundur të

<sup>8</sup> Teksti burimor gjermanisht: „dramburi te clofto goglie hätte nach unserer “korrekteren” Deskription folgende Form: trámburë të kloftë golja (goλa)” duke i dhënë asaj kuptimin “t’u dridhtë goja (prej një sëmundjeje ose zemërimi)” (Braun & Camaj 1972 5)

<sup>9</sup> Matzinger 2010 49, shën. 50. Po në këtë shënim Matzinger mënjanon me të drejtë qđo lloj spekulimi që mund të bëhej me një perceptim të gabuar të autorit venedikas të zanores fundore të supozuar [-a] si [-e] përderisa kjo zanore në venecianishten e kohës ishte më se e qëndruesh-me në sistem.

<sup>10</sup> Shih shën. 8

qëmtojmë në letërsinë albanologjike kanë të bëjnë kryesisht me përmendjen deri edhe përshkrimin e saj si përmendore e lashtë e shkrimit shqip,<sup>11</sup> kështu që lejohemi tash të përqendrohem i vetëm me analizat filologjike e gjuhësore të Camajt dhe Matzinger-it, duke përcjellë si karakteristika të përbashkëta në hulumtim, sa vijon:

- Të dyja analizat marrin si pikënisje një tip strukturor më se të përhapur ndër formulat e mallkimit në gjuhën shqipe, në të cilin O(bjekti, kundrina) përfaqësohet gjithherë me një klitik (= trajtë e shkurtër e përemrit vtor në rasën dhanore), P(redikati) përdoret sipas rastit në një trajtë të thjeshtë ose të përbërë (jo)aktive të mënyrës dëshirore, qoftë kjo në kohën e tashme sintetike, apo një e kryer (e përbysur) analitike, ndërkohë që S(ubjekti) shfaqet në çdo rast në trajtë të shquar: O + P + S, khs.: a) *t'u mylltë goja* dhe b) *myllur të qoftë goja ~ të qoftë myllur goja*, (gjeg. veriper.) *të kioftë m(b)yllum goja*, e kështu me radhë, p.sh.: *t'u nxiftëjeta, të hëngërt mortja, të raftë pika, të rëntë damllaja, të marrtë djalli* etj. Në të gjitha rastet e kësaj natyre subjekti sillet pra në pikëpamje leksiko-gramatikore gjithmonë si emër në trajtë të shquar. E kjo vërejtje mendojmë se e bën më se të diskutueshme praninë, përkatësisht njohjen e këtij tipi strukturor edhe si model bazë edhe për Formulën tonë.

- Analizat e derimëtanishme tentojnë të rindërtojnë një realitet gjuhësor, duke pranuar si të mirëqenë një numër të konsiderueshëm dukurish fonetike, përkatësisht shfytërimesh të karakterit grafik, të cilat e tejkalojnë vetë numrin e gjymtyrëve të fjalisë, khs.: a) zanorja qendrore [ə] barazohet grafikisht sipas rastit me <i> (C[amaj], M[atzinger]) dhe <ã> (M) te <drâburi>; me <e> te <te> (C, M) dhe <goglie> (M); si edhe me <o> te <clofto> (C); ndërsa b) zanorja e hapur [a] barazohet me <e> te <goglie> (C); gjithashtu nuk mungojnë të njihen si të mirëqena edhe c) dy procese asimilimi largvajtës, si p.sh. [t] → [d] te <drâburi> (C) dhe [ə] → [o] te <clofto> (M); së fundi shtojmë d) se të dyja interpretimet zbërthejnë grafinë <ã> në gjymtyrën e parë ashtu siç pritet, d.m.th. sipas rregullave ortografike kohës, në sekuencën |am|: |dramburi| (C, M).

### 3. Tentativë për një interpretim të ri filologjik

Dy vërejtjeve të mësipërme mund t'u shtojmë tash edhe një të tretë që ka të bëjë me një vëzhgim të përgjithshëm në analizën e diskursit letrar: kujt i drejton epiroti mallkimin e vet? Në të dyja interpretimet e mësipërme, sikurse edhe në citimet që i janë bërë deri sot Formulës në letërsinë shkencore albanologjike fitohet menjëherë përshtypja se është bashkëbiseduesi, pikërisht i zoti i mejhanës, ai, të cilit epiroti i lëshon mallkimin e vet. Megjithatë edhe nga ajo copëz e shkurtër

11 Shuteriqi (1978) 2005<sup>4</sup> 79; Elsie 1995 35v.; Ismajli 2000 71.

dialogu që përcollëm të përkthyer më lart (§ 1b) vështirë se mund të mëtøjmë patjetër që epiroti i drejtoi mallkimin pikërisht atij. Përshkrimi i rr Ethanave të përdorimit të Formulës në tekst lë të paktën të hapur opsonin që epiroti, pas gjase, mund t'i ketë lëshuar atë sharje/mallkim vetes, më saktë gojës së vet, meqë futi hundët në meselenë ë atij basti, por që gjithsesi ai me zgjuarsi gjeti menjëherë rrugëzgjidhje për t'i shpëtuar dorëzanisë. Duke këqyrur tash këtë opson si të mundshëm ne hapim dashur pa dashur rrugën drejt një interpretimi të ri filologjik gjuhësor të vetë Formulës, të cilin duhet ta shtrijmë natyrshëm në tri rrafshe: a) grafematik-tingullor; b) strukturor-gramatikor; dhe c) dialektor-historik.

### a) Karakteristika të karakterit grafematik dhe fonetik/fonologjik të tekstit

Duke nisur analizën tonë, të nxitur pikërisht nga këto premisa, pohojmë fillimi shqimin që autor i vështirë të ketë pasur atëbotë modele të gatshme të shkrimit të shqipes dhe, ashtu siç pritet, ka pasqyruar atë formulë grafikisht duke u mbështetur në kodin alfabetik dhe rregullat e ortografisë italiane të kohës. Parë nga kjo perspektivë vështirësitë e paraqitjes grafike të tekstit shqip në rastin konkret rezultojnë të jenë gjithsesi minimale. Kështu, përpos bashkëlidhjes së kudogjendur dyfishe *shkronjë ~ fon ~ fonemë* për <e> ~ [ə] ~ /ë/ (krahas /e/), e cila na shfaqet rregullisht në kulturën e shkrimit shqip të arealit të Veriut katolik, mund dhe duhet të mbajmë parasysh edhe ndonjë anomali të mundshme vetëm sa i përket nistores <d> të gjymtyrës së parë <drâburi>, e cila parakupton paraqitjen grafike të mbylltores së zëshme [d] ~ /d/, por që potencialisht mund të përdorej nga autor i për të paraqitur grafikisht bashkëtingëlloren frikative [ð] ~ /dh/, e cila ishte po aq e huaj në sistemin fonetik të italishtes. Përndryshe askush nuk vë dot në dyshim bashkëlidhjen <gli> ~ [ʎ] ~ /lj/ në gjymtyrën e fundit <goglie> me model ortografinë e italishtes së kohës. Duke mbajtur parasysh këto tipare grafike në bashkëlidhje me gjegjëset fonetike-fonologjike, lejohemi të tentojmë tash një hap të parë në tejshkrimin diplomatik të tekstit, duke e paraqitur si vijon: 1. |<Drâburi> të klofto goljë!.

### b) Tipi strukturor që përfaqëson Formula e Mallkimit

Ky hap i parë që ndërmorëm në tejshkrimin diplomatik të grafisë së tekstit, ndihmon deri diku hetimin e një tipi të ri strukturor formulash të njashme mallkimi shqip, ku mund të ngërthejmë edhe mallkimin e epirotit. Si pikënisje në këtë rast lejohemi të marrim karakteristikat gramatikore që përcjell grafia e gjymtyrës së fundit, pas gjithë gjasash një emër në rasën emërore (= Subjekt) në trajtë të pashquar: {goljë<sub>em</sub>  
nj. pashq EMËR} ~ [goλə] = shq. let. *gojë*. Në rast se e njohim tash këtë fjalëformë si të mirëqenë, atëherë nuk do të ndeshnim asnjë vështirësi

në segmentimin e mëtejshëm të grafisë paraprijëse në dy njësi leksiko-gramatikore të mëvetësishme: <clofto> = {kloft(ë)<sub>3, nj</sub> tash dësh FOLJE} + {O<sub>pasth</sub> PASTHIRRMË} ~ [kloft<sup>~</sup>o] = shq. let. *qoftë* o. Ky zërthim në dy njësi, ndër të cilat e dyta parakupton pasthirmën e zakonshme *o!*, *oo!* në shqipe, mundëson tash me ngërthyer këtë formulë në një tip tjetër strukturor, ku gjymtyra e parë bart përgjithësisht funksionin e një thirrori, ndërsa gjymtyra e fundit përfaqëson gjithnjë subjektin (në trajtë të pashquar), të cilit i drejtohet mallkimi (ose urimi<sup>12</sup>), khs.: *plaç* të *preftë*, *o ...; jazëk* të *qoftë*, *o ...; marre* të *qoftë*, *o ...; pika* të *rëntë*, *o ...* (+ EMËR<sub>em pashq</sub>). Ngërthimi i Formulës sonë në këtë tip të dytë strukturor të mallkimeve në shqip fiton përparësi ndaj interpretimit të mëparshëm, meqë mënjanon çdo lloj pohimi hipotetik lidhur me vështirësi të ndryshme të paraqitjes grafike që mund të ketë hasur autorit tekstit, përkatësisht me veprime dukurish të ndryshme asimilimi largvajtës në shqipen e folur atëbotë, ndërkohë që bjerrja e fundores jofunksionale [-ə] (te <cloft> ← \*[kloftə] = shq. let. *qoftë*) në krasis, d.m.th. para një zanoreje (të theksuar) të njësisë ndjekëse, është një dukuri e mirënjohur gjithkur e gjithkund në shqipe. Po ashtu shkrimi i fjalë(za)ve bashkë (te <clofto>) është një çështje që ka shoqëruar gjithherë e shoqëron edhe në ditët tona shkrimin e shqipes dhe ka të bëjë kryesisht me konvencione rregullash ortografike që ndryshojnë e mund të ndryshojnë në kohë e hapësirë për çdo gjuhë letrare.

Ky interpretim i ri lidhur me tipin strukturor të mallkimit të epirotit na mundëson tash të ngjisim edhe një shkallë në tejshkrimin e tij diplomatik, khs.: 2. |<Drâburi> të kloft, o goljë!|, duke e rrudhur kështu qerthullin problematik vetëm te gjymtyra e parë: <drâburi>.

### c) Çështje të interpretimit dialektor dhe diakronik

“Do të ishte edhe për gjuhëtarë të tjerë me interes, që kjo fjalë të bëhej e njohur sa më parë, meqë fjala e parë *dramburi* [= <drâburi>] mund të bartë kuptime të ndryshme. Kuptimi i fjalisë, d.m.th. mallkimi mbetet i pandryshueshëm.”<sup>13</sup> Citojmë kështu një pasazh të shkëputur nga letërkëmbimi i Camajt me Braun-in (Camaj më 17.07.1970), i cili i parapriu botimit të përbashkët të këtij sensacioni në botën filologjike. Dhe është fakt që kjo grafi, përkatësisht kuptimi dhe statusi leksiko-gramatikor që ajo sendërtón, mbeten edhe sot e gjithë ditën të pasqaruara bindshëm. Siç përmendëm edhe më lart (§ 2), Camaj parapëlqen t'i njohë kësaj grafie statusin e formës së pashtjelluar pjesore të foljes *trembem*, khs.:

<sup>12</sup> Për urimet dhe pëershëndetjet në shqipe dhe modelet e tyre shih Shkurtaj 2001 195vv.

<sup>13</sup> “Es wäre auch für andere Sprachwissenschaftler interessant, dass dieser albanische Satz so schnell wie möglich bekannt wird, da das erste Wort ‘‘dramburi’’ verschiedene Deutungen haben könnte. Der Sinn des Satzes, d.h. der Fluch, bleibt unverändert.“ (Camaj drejtuar Barun-it, letër e dt. 19. korrik 1970)

dial. tosk. *trëmburë* krahas *trámburë* (tash. *trámbem*, *trëmbem*, *tramarínj* – Meyer 1891 436: prej lat. *tremō*) dhe me një përdorim semantik burimor \*“dridhem”, duke i dhënë kështu gjithë shprehjes një kuptim paksa të kërkuar: “t’u dridhtë goja (prej një sëmundjeje ose zemërimi)”. Matzinger e parashikon me pikëpyetje këtë shpjegim tentativ, edhe pse bashkohet me interpretimin e statusit gramatikor të kësaj fjalëforme si një formë pjesore me ndajshtesën e njohur {-urë} të toskërishtes (~ gég. {-un(ë)}). Është madje pikërisht kjo fjalëformë e supozuar që sillet nga të dy studiuesit si dëshmi kryesore për të saktësuar burimin dialektor toskërisht të vetë mallkimit të epirotit.

Ndërkallja e Formulës sonë në një tip tjetër strukturor të mallkimeve shqip e ndërlikon pa dyshim edhe më tej hetimin e kësaj grafie, e cila tash nuk jep më shkas pér t’u vështruar (vetëm) si një formë e pashtjelluar pjesoreje, përkundrazi lë po aq shkas të ngrihen pyetje të tjera qoftë lidhur me interpretimin dialektor dhe diakronik të vetë Formulës, ashtu edhe me atë etimologjik të njësisë leksikore që përcillet me shkrim prej saj. Në pamundësi të japim përgjigje të sakta pér çdo pyetje, po mjaftohemi këtu me disa konsiderata të përgjithshme, që shpresojmë se do të mund të nxisin debatin albanologjik në të ardhmen:

- Burimi dialektor toskërisht i Formulës, përkatësisht i informantit të saj atëbotë, nuk mund të vihet në asnjë rast në dyshim, edhe sikur kjo grafi do të shpjegohej ndryshe, pra jo më si pjesore me alomorfin dialektor {-urë}. Bashkëlidhja e tipareve fonetike dialektore /kl/ dhe /lj/ me njëra-tjetrën na shpie pa vështirësi drejt ngulimeve arbëreshe në Jug të Italisë, e pse jo pikërisht në Sicili, ku ruhen ende sot e kësaj dite si tipare dialektore arkaike qoftë togu bashkëtingëllor /kl/ ashtu edhe fonema /lj/ = [ʎ].<sup>14</sup> Në të mirë të këtij mendimi ndikon ndoshta edhe rrëthana se epiroti durrsak zbret, kërkon dhe gjen mbesën pikërisht në një qytet-port të Sicilisë.<sup>15</sup>

- Zhvendosja e Formulës në ato rrëthina dhe rrëthana e ndërlikon edhe më shumë depërtimin – me metodat e sotme të studimit diakronik – deri tek etimoni i njësisë leksikore që fshihet pas grafisë <Drāburi>, e cila në rastin më të mirë do vështruar si një *hapax legomenon* në kulturen e shkrimit shqip, me mundësi të ndryshme tejskrimi, khs.: |drambur°|, |drabur°|, |drapur°|, |drébur°|, |drëmbur°|, |dhrambur°|, |dhrapur°| etj.; me status leksiko-gramatikor të panjohur: pasthirmë, emër etj. deri edhe pjesore (?); e me një etimon fare të paqartë. Aq më tepër që në këtë rast vijnë në vështrim huazime të burimeve nga më të ndryshmet (italian, sicilian, grek, arab etj.?) e sidomos përdorimi i

<sup>14</sup> Shih Guzzetta 1978 2, 52; Mandalà 1992 21, 47.

<sup>15</sup> Për emigracionin arbëresh në Sicili si edhe historinë dhe mitin e ngulimeve arbëreshe në Italinë e Jugut shih së fundi Mandalà 2009<sup>2</sup>.

një fjale-kod apo fjale-fluturake, që gjëzonte një konotacion të caktuar (negativ) në diskursin publik, pas gjase në Sicili, (vëtëm) në gjysmën e dytë të shek. XV.

Dëshira për të zbërthyer këtë enigmë të fundit në tekstu, kërkon shumë më tepër kohë, përpjekje, mund e sidomos fantazi, çka nuk i parashihet aspak koncepti fillestar për realizimin e këtij studimi modest që po i paraqesim debatit të sotëm albanologjik. Gjithsesi konstatimi i bëre dikur nga Camaj ruan sot e gjithë ditën vlerën e tij të dikurshme: “Kuptimi i fjalisë, d.m.th. mallkimi [i epirotit – B.D.], mbetet i pandryshueshëm.” (§3c)

### Epilog: manipulimi i etnikëve

Në një reagim të kohëve të fundit, studiuvesi arbëresh Gianni Belluscio (gazeta “Panorama”, dt. 1 dhjetor 2011) nuk e fsheh aspak zemëratën e vet ndaj manipulimit që i bëhet prejardhjes etnike të heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) në një botim enciklopedik të porsadalë në treg *L'atlante “Bandiere e Stati del mondo”* prej shtëpisë botuese “Touring Editore” (nën përkujdesin e Carlo Troia-s). Sigurisht që kjo librushkë nuk do të tërhoqte patjetër vëmendjen e rretheve letrare si edhe të botës shkencore albanologjike, sikur të shfaqej e vetme në tregun e sotëm ndërkombëtar të librit. Përkundrazi kemi të bëjmë më fort me një vijimësi në shtypin divulgativ të një hullie të lashtë<sup>16</sup> që thelloi më tej një ndër punimet e fundit monografike me pretendim shkencor të historianit me origjinë nga Zvicra, Oliver Jens Schmitt, që mbante si titull burimor *Skanderbeg. Der neue Alexander auf dem Balkan* (Regensburg 2009), por që çuditërisht pa së pari drithën e botimit shi në një version të përkthyer shqip prej Dr. Ardian Klosit (*Skënderbeu*, Tiranë 2008). Sigurisht që reagimi i shkencës dhe i inteligjencës shqiptare ndaj atij botimi të parë aspak fatlum – d.m.th. i përkthimit shqip – ishte ashtu siç pritej, shumë i ashpër. E kjo nuk kishte të bënte aspak me synimin e deklaruar prej autorit në libër që të demitizojë mitin e Skënderbeut, qoftë ky edhe një hero legjendar vetëm i popullit shqiptar. Syzimi i tij është largvajtës dhe ka të bëjë më fort me deetnizimin, më saktë deshqiptarizimin, jo thjesht dhe vetëm të personit historik me emër të latinizuar Georg Castriota apo Georgius Castriottus [= Gjergj Kastrioti<sup>17</sup>], të cilin ai gjithsesi e paraqet më fort si

<sup>16</sup> Debat i albanologjik mbi prejardhjen etnike të Gjergj Kastriotit dathet me siguri në vitin 1636, kur Frang Bardhi (= lat. Franciscus Blanc(h)us) i përgjigjet me një botim apologjik (Venedig 1636) manipulimit të prononcuar katër vjet më parë prej ipeshkvit të Bosnjës Joannes Tomcus Marnavitius, i cili mëtonë origjinën e Gjergjit prej Bosnjës, shi prej familjes silave Marnavić. Ky botim nuk gjen vend as në listën e burimeve dhe të bibliografisë shkencore të Schmitt-it (2009) edhe pse është i mirinformuar për ekzistencën e tij.

<sup>17</sup> Ndërsa emrin e të atit dhe të birit të heroit Schmitt-i e shkruan me vetëdije – e pse jo në mënyrë thjesht provokuese dhe tendencioze – në formën e sillavizuar *Ivan* për t’iu mbetur gjoja

një zindjellës e bakesës të shqiptarëve,<sup>18</sup> përkatësisht të asaj hapësire nebuloze, për çdo rast multietnike, ku ai e më parë familja e tij fisnike – e si e tillë pa kurrfarë ndjeshmërie etnike-kulturore e gjuhësore – shtrinin dikur sundimin e vet.

Ky syzim ogurzi është shtrirë ndërkokë gjithkund në aktivitetin me pretendim albanologjik të Schmitt-it,<sup>19</sup> duke ngërthyer në të vetë matriksin e kulturës etnike shqiptare thuaje në të gjithë identifikatorët themelorë të saj, e sidomos sa i përket: a) hapësirës kompakte etnike shqipfolëse në Ballkanin Perëndimor; b) gjuhës shqipe si mjet komunikimi i përbashkët, e për rrjedhojë edhe c) traditave themelore në mënyrën e jetesës së asaj bashkësie që komunikonte dhe komunikon sot e gjithë ditën po në këtë gjuhë. Nuk është pra aspak rastësi që ky historian dhe biograf postmodern i Skënderbeut, përkatësisht një nihilist i vonuar i gjithë rezultateve të shkencave historike shqiptare prej gjysmës së dytë të shek. XX, madje me ndonjë përashtim fare të rastit edhe syresh të ditëve tona: a) shënjuesit territorial "Albanien" (*Dheu i Arbënit, Arbëni/-ri*) i jep statusin e një amebe që ndërron formë e bosht sipas kohës e rastit (2001 63vv.; 2009a 61v.); b) për shënjuesin "Albaner" (*arbër*) më fort se sa një shënjues etnik të mirëfilltë e përcjell si një mishmash social-ekonomik e krahinor – por aspak njëgjuhësh –, që i bashkohet krejt panatyrshëm konceptit territorial "Albanien" gjithsesi pa asht e formë (2009a 62v.; 2009b 353v.); aq sa – c) duke zhvilluar një koncept postmodern "Albanischsprachiges Südosteuropa" (= *Eropa Juglindore Shqipfolëse* – Schmitt 2010 7) – d) më fort se sa për një bashkësi etnike-gjuhësore unike shqiptare guxon të mëtojë me ton mbushamendës që në këtë hapësirë krejt amorfë gjëllinin atëbotë, siç mund të gjëllinë sot e gjithë ditën, thjesht dhe vetëm "die albanischen Sprachgesellschaften" (= *Shoqëritë gjuhësore shqiptare* – nënvizimi i vetë autorit – B.D.; shih Schmitt 2010 7vv.). Ky koncept, që shumëkush gjëzon tash të drejtën ta damkosë si diskriminim racist i mirëstudiuar, por i neveritshëm, ndaj etnosit dhe kombit shqiptar, sipas tij "ndihmon për të nxjerrë më fort në pah marrëdhënet e shumanshme socio-

---

korrekt burimeve dokumentare (2009 355v.), ai megjithatë nuk guxon të arrijë në pikën më kulture të daldisë së vet duke tjetërsuar edhe emrin e Gjergjit në trajtën sllave *Durad*. Gjithsesi operacioni etimologjik që bën në tekstu lidhur me prejardhjen (greke) të emrit familjar *Castriota* (2009 25vv.), të kujton sot spekulimet që mund të bëhen lidhur me prejardhjen e emrit familjar "Kovaçi" në kantonet e Zvicrës, ku kemi sipas rastit variantet gjermanisht: *Schmit, Schmitt, Schmidt, Schmid* etj.; frëngjisht: *Farrant, Fargerant*; italisht: *Fabri* dhe (friaul. ladin.) *Faver*; retoromanisht: *Farrè; Faver* etj. Në bashkësinë etnike shqipfolëse përjetojmë gjithsesi një situatë krejt tjetër, pavarësisht nga burimi etimologjik i njësive leksikore, që qëndrojnë në bazë të emrave (sinonimikë) familjarë shqiptarë, si: *Farka, Kovaçi, Demiri, Demiraj, Kudhri* etj.

18 Shih edhe Schmitt 2010a 242vv.

19 Shih sidomos 2010a 237vv.; 2010b 7vv.

kulturore të shoqërive gjuhësore shqiptare me bashkësitë kulturore-gjuhësore sllavojugore, greke, arumune dhe turko-osmane, me të cilat shqipfolësit kanë qëndruar prej shekujsh në kontakt të ngushtë hapësinor.” [nërvizimet të gjitha prej nesh – B.D.]<sup>20</sup>

Sigurisht që për ta mbarështuar këtë bindje *ad hoc* e – më keq! – përtë bërë atë të besueshme në debatin shkencor, Schmitt-it i duhet të lëré detyrimisht mënjanë farkën e historianit dhe të fryjë e të shfryjë kacekun e kovaçit antropolog, madje edhe të ndërhyjë në mënyrë diletanteske në laboratorin sakral të filologut, ku sigurisht edhe dështon. Dështon se ende nuk është i ndërgjegjshëm sa dhe siç duhet për vlerën dhe rolin që ka luajtur dhe luan gjuha në matriksin e kulturës etnike të një populli/kombi (ballkanik). Po të ishte vërtet i ndërgjegjshëm për këtë rol, ai do të kishte mësuar e njohur shpejt edhe prejardhjen etnike-gjuhësore të personit historik me emrin *kuptimplotë Gjergj Kastrioti* (lat. *Georg Castriota, Georgius Castriottus*), në mos edhe të heroit legjendar të shqiptarëve, me emrin po aq *kuptimplotë Skënderbeu* (lat. *Scanderbegh*), ose të paktën të respektonte sipas parametrave të sotëm të civilizimit modern vetë vullnetin e individit, që vjen me thënë pohimin në mos edhe vetë dëshirën e Gjergjit, kur hidhte dikur me shkrim në letër të bardhë, se: “Në rast se kronikat tona nuk gënjejnë, ne quhem epirotë”.<sup>21</sup> Cilët gjëzonin atëbotë në rrëthet intelektuale e klerikale, shqiptare dhe evropiane të drejtën të quheshin dhe t’i quanin epirotë, e ç’gjuhë flisin ata epirotë në epokën e heroit tonë kombëtar, këtë na e mëson edhe *Mallkimi i Epirotit* (1483), të cilin lejohemi ta përdorim tash – me plot gojën – në më shumë se një drejtim.

## Abstract

This study analyses the Albanian one-sentence text Formula e Mallkimit – (The Cursing Formula), which thank to the year it dates back to (1483), fully deserves the second position in the hierarchy of the legacy of Old Albanian. After a short description of the circumstances in which this document was found, Prof. Demiraj dwells on the detailed philological interpretation of the text forwarding simultaneously his

<sup>20</sup> Varianti origjinal: “Vielmehr hilft er [der Terminus “albanischsprachiges Südosteuropa” – B.D.], die engen wechselseitigen soziokulturellen Beziehungen albanischsprachiger Gesellschaften mit anderen Sprach- und Kulturgemeinschaften, südslawischen, griechischen, aromunischen und osmanisch-türkischen, herauszuarbeiten, mit denen Albanophone über Jahrhunder te in engem räumlichen Kontakt gestanden haben.“ (Schmitt 2010b 7v.)

<sup>21</sup> Teksti original: “Se le nostre chronache non mentono, noi ci chiamiamo Epiroti.”: Skënderbeu drejtuar princi të Tarantos, shih: Makušev II 122v.; si edhe Radonić 1942 120 e Noli (1947) 1989<sup>3</sup> 308.

own point of view. The author focuses on controversial issues such as graphematic, phonetic and phonologic nature of the text, which enables him to conclude that the origin of such text is to be sought in the Sicilian Arbëresh dialects of 15th century.

At the end of the essay, the author encourages intellectual and civic commitment of Albanologists to questions connected with the studying of ethnic and linguistic Albanian culture.

### Bibliografi e cituar

#### Burime

Bardhi, Frang (~ Franciscus Blanchus) 1635: shih më poshtë Demiraj 2008.

Bardhi, Frang (~ Franciscus Blancus) 1636: Georgius Castriottus, Epirensis vulgò Scanderbegh, Epirotarum princeps fortissimus, ac iniuctissimus Suis, & Patriae restitutus. Per Franciscum Blancum. De Alumnis, Collegij de Propaganda Fide, Episcopum Sappatensem & Sardanensem, necnon Pulatensem, aliorumque Albaniae Populorum Administratorem. – Venetiis. Typis Marci Ginammi. MDCXXXVI.

(Varianti i përkthyer shqip – Stefan I. Prifti: Frang Bardhi. Skënderbeu (Apologji), NF Tiranë 1999<sup>3</sup> – bot. i tretë].

Makušev, V. 1882: Monumenta historia slavorum meridionalium vicinorumque populorum deprompta e tabularis e bibliothecis italicis, II. Belgrad.

Radonić, Jovan 1942: Đurađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku, Srpska Kraljevska Akademija. Spomenik XCV – Belgrad.

Thommaso de Mezzo 1483: shih më poshtë Braun 1974.

#### Literaturë shkencore

Braun, Ludwig & Camaj, Martin 1972: Ein albanischer Satz aus dem Jahre 1483, në: "Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung" nr. 86, f. 1-6.

Braun, Ludwig (përkth. & bot.) 1974: Thomae Medii. Fabella Epiota, Wilhelm Fink – München.

Demiraj, Bardhyl (bot.) 2002: *Einheitlichkeit und Spaltung im Laufe des Christianisierungsprozesses der Albaner. Eine ethno-linguistische Fallstudie*, në: „Studime“ 8/9 [2001-2002] 23-41, ASHAK – Prishtinë.

- Demiraj, Bardhyl (bot.) 2008: Ditionarium latino-epiroticum per R. D. Franciscum Blanchum, (Romae 1635), Botim kritik dhe konkordanca leksikore, Botime franceskane – Shkodër.
- Dulaj, Edmond 1989: Koncepti "Epir" dhe "Epirot" në shek. XIII-XIV", në: "Studime për epokën e Skënderbeut", I, ASHSH Institut i historisë – Tiranë, f. 22-44.
- Elsie, Robert 1995: History of Albanian Literature, I, Columbia University Press – New York.
- Franz, Eva: shih më poshtë Oliver Jens Schmitt 2009a.
- Gentilini Graziella 1983: Il teatro umanistico veneto. La commedia (Tommaso Mezzo. Epirota, Giovanni Armonio Marso. Stephanium, Bartolomeo Zamberti. Dolotechne), Ravenna.
- Guzzetta, Antonino 1978: La parlata di Piana degli Albanesi. Parte I: Fonologia, Università di Palermo. Istituto della lingua e letteratura albanese – Palermo.
- Ismajli, Rexhep 2000: Tekste të vjetra, Dukagjini – Pejë.
- Mandalà, Matteo 1992: La parlata arbëreshe di Contessa Entellina (in provincia di Palermo), vol. I: Fonologia, Università di Palermo. Istituto della lingua e letteratura albanese – Palermo.
- Mandalà, Matteo 2009<sup>2</sup> (2007<sup>1</sup>): Mundus vult decipi. I miti della storiografia arbëreshe. (Seconda edizione). Università della Calabria – Rende (Cs).
- Matzinger, Joachim 2010: Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 1: Ein Überblick zur vorliterarischen Dokumentation, në: (M. Genesin, J. Matzinger & G. Vallone – bot.) "The Living Skanderbeg. The Albanian Hero between Myth and History", Dr. Kovač – Hamburg, f. 41-71.
- Noli, Fan Stilian 1989<sup>3</sup> (1947): Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405 – 1468), në: Fan S. Noli, Vepra IV: Studime historike, Tiranë (bot. origjinal: George Castrioti Scanderbeg (1405-1468) by Bishop Fan Stylian Noli, Ph. D., International Universities Press, New York 1947).
- Schmitt, Oliver Jens 2001: Das venezianische Albanien (1392-1479), R. Oldenburg Verlag – München.
- Schmitt, Oliver Jens (& Franz, E. – botues) 2009a: Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung, R. Oldenburg Verlag – München.
- Schmitt, Oliver Jens 2009b: Skanderbeg. Der neue Alexander auf dem Balkan, Friedrich Pustet – Regensburg.
- Schmitt, Oliver Jens 2010a: Skanderbeg – eine Reinterpretation, në: (M. Genesin, J. Matzinger & G. Vallone – bot.) "The Living Skanderbeg. The Albanian Hero between Myth and History",

- Dr. Kovač – Hamburg, f. 237-245.
- Schmitt, Oliver Jens 2010b: Einleitung, në: (A. Mosser – bot.) Religion und Kultur im albanischsprachigen Südosteuropa, Peter Lang – Wien et al., f. 7-13.
- Shkurtaj, Gjovalin 2001: Onomastikë dhe Etnolinguistikë, SHBLU – Tiranë.
- Shuteriqi, Dhimitër S. 2005<sup>4</sup>: Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879 – 1800, ASHSH Institut i Gjuhësisë dhe i Letërsisë – Tirana.